

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	FBI nën alarm pas sulmit kibernetik, hakerët vjedhin të dhënat e dhjetëra mijëra punonjësve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/fbi-nen-alarm-pas-it-kibernetik-hakeret-vjedhinte-dhenat-e-dhjetera-mij-i589112
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:53:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aeab9f21fa630dc62c7cf14d448b2e938a0a8e705f83f57701a746b567f71cfc
TEKSTI	b7bc3ef7a08a78fbcf5787a6785acc9399b6f6e194c1a6a65288dbbc870eba59
PAMJA	8e3ea2cbefcd1b63cfeff295deea01e99fb73b29d3e060eb7e2fe6bb9f3fa05d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	54a12042da22859f2c2b5bd58107ebcb302c8654a5245cd0863b9701d7ffc1df
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/54a12042da22859f2c2b5bd58107ebcb302c8654a5245cd0863b9701d7ffc1df>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



ie FBI nën alarm pas sulmit kibernetik, hakerët vjedhin të dhënat e dhjetëra mijëra punonjësvePrattipati takon komandantin e KFOR-it, SHBA rrahmon mbështetjen për s fundit

FBI nën alarm pas sulmit kibernetik, hakerët vjedhin të dhënat e dhjetëra mijëra punonjësve



29 Shtator 2026, 10:50Bota TEMA



Një sulm kibernetik ndaj FBI-së mund të ketë ekspozuar të dhënat personale të dhjetëra mijëra punonjësve aktualë dhe të mëparshëm të agjencisë amerikane, në atë që po konsiderohet si një nga shkeljet më serioze të sigurisë së informacionit në historinë e institucioneve federale amerikane, raporton [The New York Times](#).

Sipas gazetës amerikane, grupi i hakerëve i njohur si ShinyHunters ka arritur të vjedhë të dhëna nga portali i rekrutimeve të FBI-së, FBIJobs.gov. Mes informacioneve të komprometuara dyshohet se janë adresat e banimit, numrat e sigurimeve shoqërore, numrat e telefonit, datëlindjet, pozicionet e punës dhe të dhëna mbi detyra sensitive brenda agjencisë.

Në një memorandum të brendshëm, drejtuesit e FBI-së kanë pranuar se bëhet fjalë për një incident kibernetik dhe se të dhëna personale të stafit janë vjedhur. Agjencia po punon me supozimin se hakerët mund të kenë marrë të dhënat personale të të gjithë punonjësve të saj dhe u ka kërkuar punonjësve të tregohen të kujdesshëm ndaj kontakteve të dyshimta dhe kërcënimeve të mundshme.

Analiza e një pjese të materialeve të siguruar nga The New York Times tregon se të dhënat përfshijnë jo vetëm informacione personale bazike, por edhe emrat dhe kontaktet e familjarëve, numra identifikimi të përdorur për programin TSA PreCheck, si dhe informacion mbi njësitë ku punojnë agentët dhe emrat e eprorëve të tyre. Në disa raste, të dhënat zbulojnë pozicione në fusha veçanërisht të ndjeshme si kundërzbulimi, lufta kundër narkotikëve dhe dosjet që lidhen me Rusinë, Kinën dhe Iranin.

ShinyHunters pretendon se ka siguruar gjithashtu të dhëna mjekësore dhe materiale nga kontrollet e sigurisë së punonjësve. Autoritetet amerikane nuk e kanë konfirmuar ende shkallën e plotë të informacionit të vjedhur, por zyrtarë aktualë dhe ish-zyrtarë amerikanë kanë thënë se të paktën një pjesë e dokumenteve të publikuara nga hakerët duket autentike.

Ekspertët paralajmërojnë se rreziku nuk lidhet vetëm me publikimin e mundshëm të materialeve në internet. Të dhënat mund t'u shiten grupeve kriminale ose shërbimeve të huaja të inteligjencës dhe të përdoren për identifikimin, gjurmimin apo kërcënimin e agentëve dhe familjarëve të tyre, përfshirë edhe personelin që punon në role të fshehta.

ShinyHunters fillimisht kërcënoi se do t'i publikonte të dhënat nëse FBI nuk hiqte një paralajmërim publik kundër grupit, por më pas deklaroi se nuk kishte

ndërmend t'i publikonte dhe se nuk do të ndërmernte veprime të tjera me materialet. Ekspertët e sigurisë mbeten megjithatë skeptikë, duke theksuar se të dhënat mund të përdoren ose të shiten edhe pa u publikuar hapur.

FBI ka deklaruar se hetimi vijon dhe se është në komunikim me personat që mund të jenë prekur nga sulmi. Ende nuk është përcaktuar me saktësi se sa persona janë komprometuar, por vetë hakerët pretendojnë se bëhet fjalë për dhjetëra mijëra individë.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[OpenAI anulon lançimin e modelit të ri për shkak të shqetësimeve për sigurinë](#)

10:05 Bota / 1 koment

[Britani, lirohen me kusht pesë personat e arrestuar pranë bazës RAF Fairford, policia heton për lidhje me një shtet të huaj](#)

09:35 Bota / 1 koment

[Komploti për sulm terrorist në bazën amerikane në Britani, Rubio: I përfshirë një aktor i huaj](#)

09:05 Bota

Greva e përgjithshme në Francë prek trafikun ajror, anulohen disa fluturime në aeroportet e Parisit dhe Marsejës

08:45 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.